



VENDIM

Nr. 19, Datë 31.01.2017

**PËR
FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË
“ENERGJI UNIVERS” SH.P.K NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “KABASH” ME FUQI TË
INSTALUAR 5.8 MW.**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2 gërma ‘a’ të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1 gërma “a”; 10 pika 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 109, datë 29.06.2016, dhe nenit 19 pika 1 të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit nr.96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 31.01.2017 mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “ENERGJI UNIVERS“ sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut mbi liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “ENERGJI UNIVERS” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3; 4.1.4; 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Vërtetimin nga Gjykata dhe Prokuroria, (neni 9, pika 2 gërma “d”);
- Vërtetimi i shlyerjes së Tatim Taksave (neni 9, pika 3 gërmat “a”); do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, t`i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi të ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për liçensimin e shoqërisë “ENERGJI UNIVERS“ sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Kabash” me fuqi të instaluar 5.8 MW.
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. 19, Datë 31.01.2017

PËR

**FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË
“ENERGJI UNIVERS” SH.P.K NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “KABASH” ME FUQI TË
INSTALUAR 5.8 MW.**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kund r
Petrit Ahmeti	_____	_____
Adriatik Bego	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Maksim Shuli	_____	_____

